



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15916 Prot

Lezhë, më 26 / 09 /2022

**VENDIM**

Nr. 102, Datë 23 . 09 .2022

**PËR MIRATIMIN E PBA-së 2023-2025 TË BASHKISË LEZHË (FAZA E DYTË).**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 24.07.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të Udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”; dhe të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.23, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

**Vendosi :**

- 1.Miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë për fazën e dytë, sipas dokumentit të paraqitur të Instrumentit të Planifikimit Financiar (IPF) dhe relacionit përkatës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT LEZHË

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE E FUNKSIONEVE TË DELEGUARA

C.B.

Nr. 15814/prot  
Dat. 28.9.2022

Nr. 677/1 Prot.

Lezhë, më 28.09.2022

L e n d a : Konfirmim vendimi

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2, gërma b; ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore" dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22, datë 08.07.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 102, datë 23.09.2022 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (faza e dytë)".

**PREFEKTI**

**Gjergj PRENDI**

